VENDIM
Nr. 20, datë 30.4.2013

PËR RINOVIM LICENCE SHA UJËSJELLËS-KANALIZIME MAT
(Ndryshuar me VKM nr. 50, datë 2.12.2016)

(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 14 pika 1/a, nenit 17 të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996 "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", si dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 958, datë 6.5.2009 "Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licencë", Komisioni Kombëtar Rregullator

VENDOSI:

1. Rinovim licence për efekt të përfundimit të afatit operatorit sh.a. ujësjellës-kanalizime Mat me:

Drejtues ligjor *Arjan Lika*
Drejtues teknik Nazmi Mallunxa

2. Operatori sh.a. UK Mat autorizohet të kryejë veprimtarinë përkatëse të kualifikuar në kategoritë:

Kategoria A, për grumbullimin dhe shpërndarjen e ujit për konsum publik;
Kategoria C, për largimin e ujërave të ndotura.

3. Zona e mbulimit të këtij operatori është: Bashkia Burrel, komuna Lis.

4. Kjo licencë është e vlefshme për një periudhë 4-vjeçare deri më 29.4.2017.

KRYETARI
Avni Dervishi